



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 193, Datë 13.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“GERTI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/2 prot., datë 10.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 02.07.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me kapacitet të instaluar 10 MW, duke përfshirë dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.
- Në lidhje me sa kërkuar nga shoqëria, për përfshirjen e veprave ndihmëse, sqarojmë se në shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1291/8 prot., datë 01.07.2026, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka sjellë në vëmendje të ERE-s se referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë dhe shtimin e veprave ndihmëse apo njësive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që për sa kërkuar nga shoqëria për të përfshirë në licencën e prodhimit dhe veprat ndihmëse, t'i kërkohej MIE-s qëndrimi/vlerësimi i saj. Po ashtu, vetë ERE do të njoftojë MIE-n për këtë procedurë.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Shqyrtimi paraprak i aplikimit

- Në mbështetje të nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, u krye verifikimi paraprak i kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria.
- Nga shqyrtimi paraprak rezulton se aplikimi është paraqitur në formatin e kërkuar nga Rregullorja e Licencimit dhe është shoqëruar me dokumentacionin bazë të nevojshëm për fillimin e procedurës administrative.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (b, c, d dhe f).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “GERTI” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në datën 10.02.2026 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Vlashaj, Njësia administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, nga shoqëria “GERTI” sh.p.k.”;
- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) nr. 3502/3 prot., datë 17.04.2024, me lëndë “Miratim pikë lidhje për Central Fotovoltaike”,

- Është pajisur me VNM Paraprake, lëshuar më 18.03.2026 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “*NDERTIMI I PARKUT FOTOVOLTAIK MURATI, 10 MW*”.
- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: dëshminë e penalitetit për administratorin tjetër të saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: dokumentacionin mbështetës që vërteton se ka aftësi financiare për të mbuluar 100% të vlerës totale të investimit të projektit sipas modalitetit të parashikuar në planin e biznesit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: garancinë për panelet, në rast se e disponon një të tillë, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit.
 - **gërma “e”**: informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit.
- Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.
 - Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

2. Shoqëria “GERTI” sh.p.k., të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI